

**V E N D I M**  
**Nr.209, datë 28.4.1999**

**PËR CAKTIMIN E ADMINISTRATORËVE TË PAVARUR NË SHOQËRITË HUAMARRËSE,  
SUBJEKTE TË KONTROLLIT**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankare, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Administrimi i shoqërive huamarrëse, subjekte të kontrollit, "Vefa Holding", "Kamberi", "Cenaj & Co", "Silva", "M. Leka", "Gjallica", "Benó" dhe "Global Foods", të vazhdojë të kryhet nga administratorët e pavarur, të caktuar sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Administratorët, në përmbushjen e detyrave të tyre, ushtrojnë të gjithë kompetencat e caktuara në ligjin nr. 8215, datë 9.5.1997 ndryshuar me ligjin nr. 8227, datë 30.7.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore të dala për shoqëritë huamarrëse.

3. Në shoqëritë me më shumë se një administrator vendimet merren në mënyrë të përbashkët. Kur një administrator jep dorëheqjen apo largohet nga detyra, zëvendësimi i tyre bëhet nga Grupi Mbikëqyrës nga personat e tjerë sipas listës rezervë.

Për plotësimin e detyrave, në planin e vitit 1999, për Grupin Mbikëqyrës, shtohen 20 vetë dhe, për pagat e punës së administratorëve, një fond prej 12 milionë lekë, të cilat përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Në vartësi të nivelit të aftësisë dhe vështirësive të procesit, Grupi Mbikëqyrës, cakton pagat mujore për secilin specialist dhe administrator, brenda kufijve minimal dhe maksimal të caktuar në lidhjen bashkëlidhur vendimit.

4. Procesi i shitjes së pasurive të shoqërive huamarrëse, caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, realizohet nëpërmjet Qendrës së Ankandit, duke zbatuar kriteret e caktuara në ligjin nr. 8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë" dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

5. Grupi i ekspertëve ligjorë, i krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 250, datë 30.4.1998, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.36, datë 21.1.1999, të ndjekë të gjitha procedurat gjyqësore me gjykatat për vërtetimin e pronësisë dhe saktësimin e titujve, si dhe t'i japë Qendrës së Ankandëve asistencën e nevojshme ligjore për realizimin e kontratave të shitjes së pasurive.

6. Ministria e Financave në bashkëpunim me Grupin Mbikëqyrës të hartojnë udhëzime të veçanta për veprimtarinë e punës së administratorëve dhe të ekspertëve ligjorë dhe për rregulloren e funksionit të Qendrës së Ankandëve.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**

**NIVELI I PAGAVE BAZË MUJORE TË ADMINISTRATORËVE DHE EKSPERTËVE TË  
QENDRËS SË ANKANDIT**

Paga bazë mujore  
në lekë

|        |                                                                              |       |
|--------|------------------------------------------------------------------------------|-------|
| 000    | 1. Administrator                                                             | 4 5   |
| 45 000 | 2. Administrator në shoqëritë huamarrëse dhe arkëtimin e detyrimeve debitore | 3 5 - |
| 40 000 | 3. Specialistë pranë Qendrës së Ankandeve                                    | 3 0 - |

#### LISTA E ADMINISTRATORËVE NË SHOQËRITË HUAMARRËSE

##### 1. Në shoqërinë "Vefa Holding" sh.p.k. në administrim:

Nasip Ahmetaj

Diana Golemi

Adrian Lika

Violeta Kraja

Arben Abazi

##### 2. Në shoqërinë "Gjallica" në hetim e gjykim:

Burbuqe Duka

Lumturi Braja

Daniela Riska

Yllka Sejati

##### 3. Në shoqërinë "Kamberi" në administrim:

Ymer Liksala

Donika Papa

Mirela Musha

##### 4. Në shoqërinë "Cenaj & Co" në administrim:

Mirela Cano

Merita Çeliku

Fatmira Koxhaj

##### 5. Në shoqërinë "Silva" në administrim:

Lirika Hysi

Vjollca Gjylameti

Tushe Hoxha

##### 6. Në shoqërinë "M. Leka" në administrim:

Saniye Tafa

Liljana Enesi

Fabardha Gaçi

##### 7. Në shoqërinë "Global Foods"

Flamur Laze

#### REZERVË

1. Përparin Kadiu

2. Luan Kamberi

3. Arben Disha

4. Mimoza Sula

#### STRUKTURA E PUNONJËSVE QË DO TË AKTIVIZOHEN NË SHOQËRITË RENTIERË

|                                              |         |
|----------------------------------------------|---------|
| 1. Administrator                             | 1 vetë  |
| 2. Administrator në shoqëritë huamarrëse dhe |         |
| - për arkëtimin e detyrimeve debitore e      |         |
| - transaksioneve të pronësisë                | 21 vetë |
| 3. Ekspertët ligjorë                         | 3 vetë  |

- |                                                 |         |
|-------------------------------------------------|---------|
| 4. Specialistë pranë Qendrës së Ankandit        | 5 vetë  |
| 5. Specialistë koordinatorë në organet e rendit | 2 vetë  |
| 6. Gjithsej                                     | 32 vetë |